



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2105/ 2prot

Datë 29.08.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK  
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI SKUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË  
TJERË**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-75335-07-17-2023 me objekt “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit” me fond limit 8,006,130.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-08-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A

Skualifikimin e operatorit ekonomik B.O.E. PRIMUS ALBANIA Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k. në procedurën e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK  
*Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A  
*Lagjia Minatori, Pallati i Kulturës, Bulqizë.*

**Subjekt i interesuar:** BOE PRIMUS ALBANIA Sh.p.k. & Nexia AL Consulting Sh.p.k  
*Tirane Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1*

Në datën 26.08.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3381 dhe me nr. 2105/2023 prot., datë 28.08.2023 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-

75335-07-17-2023 me objekt “Implementimi dhe mirëmbajtje të sistemit të faturimit, migrimi i të dhënave ofrimi shërbimit dhe integrimi i sistemit të fiskalizimit” me fond limit 8,006,130.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09-08-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër SH.A

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik PRIMUS ALBANIA Sh.p.k në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK kundërshton me anë të ankesës më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Në Dokumentat e Tenderit (D.T.), tek Njoftimi i Kontratës, pika 3.1.3. (faqja 7) është përcaktuar që pagesa e Sigurimit të Ofertës të kryhet në formën e garancisë bankare, ndërkohë që O.E. KREATX e ka kryer pranë një shoqërie sigurimi dhe jo në një banke.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK pretendon se operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK pjesëmarrës në këtë procedurë nuk I plotëson.

Si më poshtë vijon:

Ne shtojcën 8 **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

Kriteri 2.3.3

**2.3.3** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Prodhuesit për sistemin e faturimit të ofruar ose Autorizimin e Prodhuesit apo të distributorit të autorizuar për implementim e sistemit të faturim arkëtimit. Në Autorizim duhet të shënohen të dhënat e plota të kontaktit të prodhuesit. Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 29.08.2023.*

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**